



Like 46 Tweet 3

3

Kandiq: Armë të vetme kundër mohimit të krimeve janë faktet dhe dëshmitë

🕒 4 Shkurt 2015 - 20:33 -

Natasha Kandiq, koordinatore e projektit 'Libër Kujtimi i Kosovës' i Fondit për të Drejtën Humanitare, ka thënë në Rubikon të KTV-së se nëse diçka lidhur me luftën mund të ndodhë gjë e mirë, atëherë kjo është që të ruhen të dhënat dhe të ruhen faktet.

Këtu u dëshmuar se lufta për të vërtetën është e rëndë, kemi parë sa e lehtë është të bëhet luftë, ku vriten civilët, ka thënë ajo.

Në këtë intervistë ajo flet për të gjitha faktet e dëshmitë të publikuara në librin i cili është promovuar sot në Prishtinë.

Kelmendi: Sot e keni prezantuar "Librin e kujtimit", i cili përmban shifrën prej 13 535 të vdekurish gjatë luftës. Për çfarë shërben ky libër?

Kandiq: Fjala është për bazën e të dhënave të "Librit të kujtimeve" që mbledhi të dhënat e të gjithë atyre që humbën jetën gjatë luftës në Kosovë. Kur them pothuajse të gjithë, ekziston mundësia që dikush nuk është paraqitur dhe që nuk ka familje e që askush nuk e ka paraqitur atë. Baza e të dhënave tashmë e ka edhe verifikimin ndërkombëtar. Ekspertë të respektuar ndërkombëtarë për të dhënat për humbjet e njerëzve në lufta në dy vjetët e fundit, kishin rastin të studionin këtë

Es me kohën

databazë dhe në fund të vitit 2014 vlerësuan se është fjala për bazën më të besueshme të të dhënave rreth viktimave të luftës në Kosovë. Dhe kjo është një mirënjohje që hapë rrugë të mendojmë se për çka duhet të shërbejë kjo bazë e të dhënave. Praktika tregoi se vërtet ekziston një numër i madh situatash, veprimesh dhe rastesh në të cilat kjo bazë mund të ndihmojë në zbulimin e fakteve, verifikuar të vërtetën dhe qëllimi i kryesor i saj është të ruhet e vërteta dhe të ruhet nga çdo revizion i mundshëm. Praktika në Ballkan na tregoi se asnjë dokument deri tash nuk ka shpëtuar pa ndonjë revizion. Por ky libër janë aq të verifikuar, saqë nuk ekziston asnjë mundësi që kjo të ndodhë në histori e të thotë që kjo nuk është e vërtetë, kemi dëshmi që këta njerëz nuk u vranë, nuk u zhdukën. Nëse diçka lidhur me luftën mund të ndodhë gjë e mirë, atëherë kjo është që të ruhen të dhënat dhe të ruhen faktet. Këtu u dëshmuar se lufta për të vërtetën është e rëndë, kemi parë sa e lehtë është të bëhet luftë, ku vriten civilët. Që nga 1 janari 1998, deri në fund të luftës edhe pas luftës gjatë 2000, kishim rreth 13535 njerëz që u vranë apo u zhdukën. Ishte e lehtë të vriten, janë civil shumica. Por këtë duhet dokumentuar. Dhe kur duhet nga ata që i kryen krimet dhe i urdhëruan të marrin pranimin për atë që e bënë, kjo është e vështirë. U dëshmuar se një hap drejt të së vërtetës është shumë i vështirë për t'u arritur. Shembulli më i mirë është si të dëshmojmë që është e vërtetë që njerëzit në Drenas a Skenderaj u vranë apo u zhdukën, në praninë e brigadës 37, dhe se ushtarët e kësaj brigade janë përgjegjës për vrasjen e së paku 400 civilëve. Kemi parë se çka po ndodh që nga viti 2012 lidhur me këtë situatë në Drenas e Skenderaj, kur FDH më 2012 në Serbi në bazë të hetimeve dhe në bazë të dokumenteve të gjykatave, Tribunali në Hagë kishte publikuar dosjen e parë se kush ishte Lubisha Diković, dhe atëherë Prokuroria për krime lufte e para doli në mbrojtje të këtij njeriu, duke thënë se me dy klikime në kompjuter nuk ka dëshmi kundër tij. Ata nuk deshën të shohin asnjë dokument të asnjë institucioni, por dolën me vlerësime politike.

Kelmendi: Përse kjo ndodhi?

Kandiq: Ngase kjo nuk ishte institucion i pavarur dhe në atë kohë kishin urdhër që duhet të mbrojnë institucionin e kreut të Shtabit të Përgjithshëm të Serbisë. Në publikimin e dosjes së dytë ndodhi e njëjta dhe i tërë shteti i doli në mbrojtje ushtrisë. Dhe mbrojtja institucionin e Shtabit të Përgjithshëm, dhe FDH u akuzua për komplot kundër ushtrisë dhe institucioneve shtetërore. Kjo luftë për pranimin e fakteve është e vështirë, përkundër akuzave politike, është e vështirë t'u kundërpërgjigjesh fakteve, dëshmi, dokumenteve, sepse ekziston një vullnet politik. Mendoj që me këtë rast të gjithë këto raste që u konfirmuan, dëshmitë e dëshmitarëve, dokumentet të cilat u nënshkruan nga dora e këtij gjenerali, ato assesi nuk mund të zhduken dhe është çështje ditësh, kur ato do të dalin në pah. Do të shohim si do të sillet Prokuroria për Krime lufte, e cila një herë veprimi politikisht. Do të shohim si do të sillet EULEX-i dhe institucionet kosovare që mund të ndihmojnë në sigurimin e dëshmitarëve që do të tregojnë se çka ndodhi.

Kelmendi: A kishte reagime nga autoritet kosovare dhe nga EULEX-i sa i përket kësaj?

Kandiq: Ishte vetëm një reagim i kryeministrit, i cili kishte thënë se i japin përkrahje një organizate joqeveritare, e cila tregon për atë çka ndodhi dhe konsideron se oficerë s'bën të jenë në pozita të tilla. Të shohim se çka do të ndodhë, por në përgjithësi nuk është e lehtë të luftojmë kundër vullnetit politik të mohojnë atë çka ndodhi. Arma e vetme janë dokumentet në këtë rast, ekzistojnë dokumente dhe ekziston shpresa që faktet do të jenë të barabarta në luftën kundër mohimit.

Kelmendi: Në këtë rast shihet se këto dokumente nuk mjaftojë për qeverinë, sepse ata ju akuzuan se ju vetëm doni të diskualifikoni ushtrinë?

Kandiq: Këto janë akuza politike. Dokumentet ekzistojnë dhe janë të qasshme edhe në faqen e Tribunalit të Hagës. Askush nuk mund të mohojë se Brigada 37 nuk ishte e pranishme në Skenderaj dhe Drenas dhe ushtarët kishin kryer krime në Rrezajle e Çikatovë, kishin vrarë civilë.

Fshatarët fshiheshin në male. Ata nuk ishin terroristë, por ishin fshatarë që iknin nga granatim, armatimi i rëndë, nga vrasjet ... Këto janë fakte që askush me qëndrime politike nuk mund t'i fshijë. Ndonëse aktualisht duket që po mbisundojnë këto kualifikime politike, komplete dhe tentime për diskualifikimin e institucioneve. Përveç kësaj, besoj se ekzistonte dhe një dritare e vogël që na jep shpresë, kryeministri serb na ka thënë se ai personalisht beson se gjenerali Diković nuk është kriminel luftë. Por, se ato që ai i beson duhet të verifikohen nga institucionet përkatëse. Ato duhet të dëshmojnë nëse ka dokumente e dëshmi që flasin që ai i shkeli ligjin dhe nuk i kishte parandaluar krime, por i kishte lejuar.

Kelmendi: Por institucionet u përgjigjën?

Kandiq: U përgjigjën në janar 2012, por këtë herë nga këto institucione, mendoj në Prokurorinë për Krime Luftë, u dëgjua që kërkojnë të dhëna të gjitha nga FDH, që të mund të bëjnë një shqyrtim. Nga fondi u është përgjigjur që 90 % e këtyre dokumenteve, në të cilat bazohet dosja, paraqet dokumentimin i cili është publik, që është në ueb-faqen e Tribunalit të Hagës, janë dokumente ushtarake. Në anën tjetër, ka edhe dëshmitarë të mbijetuar që mund të dëshmojnë atë çfarë kishte ndodhur në Skenderaj dhe Drenas. Por EUEX-i besoj se do t'i ndihmojë Prokurorisë për krime luftë, sepse fondi disponon me deklaratat. Por që një institucion të hap hetim, duhet të flasë me dëshmitarët. Institucionet e Kosovës janë të gatshme të ndihmojnë në aspektin e komunikimit.

Kelmendi: Çfarë epilogu prisni në këtë situatë?

Kandiq: Unë druaj nga situata politike, e cila i jep përkrahje gjeneralit dhe zëvendësohet teza që ka të bëjë me turpërimin e një gjenerali, por në emër të shtetit serb, në emër të Marrëveshjes së Brukselit, në emër të institucioneve të Kosovës, në emër të bashkëpunimit të Serbisë me Kosovën është me rëndësi që me rrugë ligjore, ky rast rreth gjeneralit të qartësohet dhe të lihen anash vlerësimet politike, por të merren në shqyrtim dokumentet dhe të dëgjohen dëshmitarët që të mund të sqarohet situata, me ç'rast 400 njerëz humbën jetën.

Tash vjen në pyetje kredibiliteti i institucioneve serbe, sepse sot Serbia thotë se nuk është çfarë ishte, synon anëtarësimin në BE dhe kryeministri pohon se ai dëshiron që gjithçka të hetohet. Por shohim se disa institucione japin vetëm përgjigje blanko ndaj këtyre vlerësimeve.

Mendoj që situata e mirë është që kjo qeveri e re nisi një proces të ndryshimit të raporteve mes Serbisë dhe Kosovës. Pushteti i shkuar, sado që ne e quajmë demokratik, nuk bëri asnjë hap në raport me raportin me Kosovën. E tash është në veprim pushteti i ri. Kryesisht kemi dëgjuar qëndrime të njëjta, si të pushteti të shkuar, do të thotë mbrojtja e ushtrisë, gjeneralëve, krerëve të ushtrisë. Megjithatë, ekziston një hapësirë që është hapur pikërisht për ndryshimin e raporteve mes Kosovës e Serbisë, pastaj kemi negociatat në Bruksel që po shkojnë në drejtim të mirë. Ekziston një mundësi që këtë herë të kemi epilog ligjor. Nëse kjo s'ndodh, vërtet kjo luftë për faktet dhe pranimin është aq e vështirë, aq e pakapshme, sa që do të sjellë shumë njerëz e institucione dhe vende në situatë të mendojnë se cilat janë ato mjete me të cilat mund të arrihet pranimi i përgjegjësisë për krimet.

Kelmendi: Të kthehemi te shifrat. Numri që ju përmendët në libër, 13 535, e dimë që në vitin 2006 qeveria serbe e dha shifrën prej rreth 6000 të vrarëve në Kosovë. Por në librat e shkollave fillore të Kosovës ekziston shifra prej rreth 20 mijë shqiptarëve të vdekur. Si do të pranohet shifra juaj?

Kandiq: Kjo shifër duhet të pranohet, sepse nuk është shifër pas së cilës nuk ka emra. Ne fillimisht kujdeseshim që të verifikonim të dhënat. Ka aq shumë të dhëna për njerëzit, të cilët humbën jetën gjatë luftës së Kosovës. Ka shumë evidencime të vlefshme për viktimat shqiptare. Ekziston një nga

viti 2003, që e përpiloi LDK-ja, ku ka më shumë se 10 mijë viktime. Kosova po ashtu bëri një evidencë të madhe, pastaj bordi për të drejtat e njeriut bëri një evidentim për viktimat. Po ku qëllon dallimi?

Fondi për të Drejtën Humanitare është organizatë e cila ka qasje të pakufizuar ndaj dëshmitarëve në Kosovë, si në shumë shtete të tjera në Ballkan. Falë kësaj pozite specifike, Fondi, nga të cilat ekzistojnë dy organizata, Fondi në Serbi dhe Kosovë, kishin mundësi të mbledhin të dhëna edhe për shqiptarë, serbë, romë që humbën jetën gjatë luftës. Kjo është përparësia jonë që kjo është organizatë që i mbijetoi luftës dhe s'pati kufi dhe kishte qasje ndaj dëshmitarëve për të mbledhur të dhëna dhe në fund i verifikoi ato të dhëna nga vetë baza jonë.

Dy vjet zgjati verifikimi i të dhënave dhe konfirmimi që në këtë libër të mos jenë 3190 emra që ndodhen në evidenca të tjera, me verifikime në terren. Janë verifikuar më se 2000 emra, u konfirmua se ka gabime që janë 580 viktime të paraqitura që janë vërtet viktime të luftës, e meqë nuk ndodhen në bazën tonë, nuk do të thotë që s'janë viktime. Është konfirmuar kjo. Por janë 488 të cilët, në fakt, ishin të gjallë dhe u regjistruan gabimisht dhe janë rreth 150, të cilët vdiqën për shkaqe natyrore. 184 vdiqën, por jo për shkaqe lufte. 751 persona me emër që janë në evidenca janë të panjohur, si në vendbanimet e tyre, ashtu edhe në vendlindjet e tyre dhe në vendet ku ndodhi ndonjë krim. Dhe tashmë kemi 1071 persona, statusin e të cilëve duhet ta verifikojmë. Kjo do të thotë se ndodh që gabimisht të regjistrohen disa njerëz. Një numër i madh ishte edhe në burg në Serbi, pastaj familjet paraqisnin zhdukjet e tyre. Në disa raste ende konsiderohen të zhdukur, edhe pse janë liruar nga burgu. Edhe me verifikimin e këtyre 1071 personave do të mund të dimë saktë se si qëndron situatat. Të dhënat në "Librin e kujtimeve" kosovare është në këtë aspekt shumë e vlefshme, sepse ka të dhëna rreth rrethanave dhe e dimë saktë se si pësuan njerëzit në Gllabaj? Gjatë bombardimeve të NATO-s si e shfrytëzoi ushtria serbe bombardimin e NATO-s, por po ashtu e dimë se 778 njerëz humbën jetën nga shpërthimet e projektilëve dhe bombave që hodhi NATO. Po ashtu kemi të dhëna që 488 njerëz vdiqën nga projektilët e NATO-s në Kosovë, 260 në Serbi.

Kelmendi: Gjatë luftës?

Kandiq: Po, por po ashtu kemi të dhëna që pa dyshim në periudhën prej janarit deri në dhjetor 1998 janë vrarë 2056 njerëz, shumica shqiptarë. 1804 shqiptarë, 289 serbë dhe 63 romë. Ne druajmë që nuk ia dolëm të vijmë te të dhënat për të gjithë romët, sepse te romët nuk ka institucione e organizata që kanë shënuar zhdukjet e vrasjet dhe është e vështirë të mblidhen të dhënat rreth tyre.

Kelmendi: Por ju mendoni që numri është më i madh?

Kandiq: Po, numri është më i madh. Ia dolëm që, për shembull, të konfirmojmë që nga 1 janari 1999 deri më 14 qershor 1999, mes 10122 të vrarëve ka të zhdukur. 203 janë romë, 1191 janë serbë, por që 8701 janë shqiptarë. Kur shihet kush janë shqiptarët, autoritetet serbe mund të thonë që janë terroristë. Shifrat tregojnë që 7346 janë civilë.

Kelmendi: Vetëm gjatë '99-ës?

Kandiq: Po, vetëm në atë kohë. Deri më 14 qershor dhe janë kryesisht fshatarë, e këtë duhet pranuar se janë fakte. Sa i përket periudhës nga 14 qershori, do të thotë se që nga 15 qershori deri më 31 dhjetor 2000 prapë kemi dhunë pas konfliktit. Dhe prapë kemi 1257 viktime. Të dhënat kanë treguar që këto nuk janë dhjetëra-mijëra viktime. Kemi të vrarë dhe të zhdukur 717 serbë, 307 shqiptarë, 233 romë.

Kelmendi: Kjo do të thotë është pas luftës?

Kandiq: Po, është pas luftës, nga 15 qershori deri më 31 dhjetor 2000. Kjo është një shifër që gjithashtu tregon se lufta nuk përfundoi, që kishte hakmarrje ndaj njerëzve të caktuar, por s'janë vetëm njerëz të një nacionaliteti, por ka serbë, shqiptarë dhe romë. Në këtë aspekt është mirë që të vazhdohet edhe procedimi penal i atyre që janë përgjegjës për krime që kanë bërë edhe të tjerët, jo vetëm serbët. Ajo që është e logjikshme, që pas tërheqjes së serbëve nga Kosova, zor se mund të fajësohet ata për vrasjen e shqiptarëve, romëve a serbëve. Kjo do të thotë se krijimi i Gjykatës Speciale për krime lufte është instrument i rëndësishëm, ngase do të sqarojë edhe këto vrasje e zhdukje edhe në kohën kur në Kosovë nuk kishte më forca serbe.

Por kur flasim për Gjykatën Speciale, kjo do të jetë gjykatë e cila do të merret vetëm me gjera të caktuara etnike, vetëm me shqiptarët pas luftës. Kjo vjen pas Tribunalit të Hagës, pasi që në Kosovë ishte edhe UNMIK-u, derisa ende e kemi EULEX-in këtu, si mund të dimë që kjo Gjykatë do të jetë më e suksesshme se këto tri institucionet paraprahe.

Një pyetje e tillë gjithmonë mund të parashtrohet lidhur me gjykimet për krime lufte, por duhet të nisem nga fakti që Tribunali i Hagës dënoi pothuajse gjithë kreun shtetëror të Serbisë së asaj kohe. Aty janë edhe përfaqësuesit e pushtetit civil të atëhershëm, janë gjeneralë të ushtrisë e policisë. Mendoj se Serbia nuk ishte shumë e suksesshme sa i përket gjykimeve vendëse, sepse është dashur të dënojë edhe më shumë, sepse Tribunali i Hagës hapi dokumente të shumta që flisnin për atë që ndodhi në Kosovë.

Por Haga dënoi edhe shqiptarë, kroatë e boshnjakë, por shifrat dallojnë.

Kelmendi: Si mendoni i dënoi?

Kandiq: Epo ishin gjashtë shqiptarë në Hagë, dy u shpallën fajtorë, katër u liruan pas një gjykimi të gjatë. Pse tash prapë të gjykohen?

Kandiq: Në Serbi janë dënuar të gjithë gjeneralët që udhëhiqni brigada, korpuse dhe i gjithë kreu shtetëror u dënua dhe kjo është e padiskutueshme, kur shohim se çfarë kishte në këtë luftë. Asnjë shtet, asnjë shoqëri nuk humb asgjë nëse procedohen ata që janë përgjegjës për krime. Kosova nuk do të humbë asgjë vetë, do të fitojë në kredibilitet shtetëror.

Por unë po flas nëse ky është ndonjë eksperiment i ri, sepse deri tash kishim 3 institucione që nuk arritën asgjë në aspektin ligjor...

Tribunali i Hagës nuk kishte përgjegjësi të gjykojë krimet e luftës që ndodhën pas 12 qershorit.

Tribunali në Hagë kishte përgjegjësi të gjykojë krimet që ndodhën gjatë konfliktit të armatosur.

Por UNMIK-u e EULEX-i e kishin këtë përgjegjësi.

Do të thosha që UNMIK-u dhe EULEX-i nuk ia dolën shumë. Ata ia dolën vetëm t'i gjykojnë disa

krime që i kryen disa pjesëtarë të UÇK-së, por kur marrim parasysh raportet e Amnesty

International dhe Human Rights Watch, nuk ekziston njëfarë vlerësimi pozitiv për atë se gjykimet në Kosovë sollën drejtësi. Nuk ka drejtësi as për familjet e kosovarëve që iu vranë familjarët, por kur merren parasysh edhe familjet e serbëve të vrarë po ashtu nuk ekziston ajo drejtësia e nevojshme.

Kelmendi: Çfarë do të ketë të veçantë Gjykata Speciale krahasuar me EULEX-in, për shembull?

Kandiq: Mendoj se Tribunali i Hagës këtë herë... nëse selia do të jetë sërish te Tribunali i Hagës, do të merret me rregullat të cilat janë rregulla që u përdorën gjatë gjykimeve edhe për krime gjatë luftës. Por ekziston një dokumentacion i madh që dëshmoi se kur bëhet fjalë për gjykimet e krimeve që ndodhën në Kosovë gjatë '98-'99-ës, por edhe më pas, atëherë nuk flitet për këtë.

Ekziston njëfarë frike dhe kjo është fakt që duhet të vlerësohet se disa dëshmitarë thjesht u zhdukën. Por, nëse gjykimet ndodhen jashtë Kosovës, do të ketë më pak frikë e më shumë qasje të hapur për dëshmitarët. Unë kam qenë ithtare e gjykimeve aty ku ndodhën krimet dhe aty ku ndodhën ata që kryen krimet. Kjo ishte një mënyrë e ballafaqimit me të shkuarën, sepse drejtësia duhet të shihet, sepse ballafaqimit me të shkuarën, ne këtë se pamë, sepse ishte larg. Nëse këto

gjykime do të jenë larg Kosovës, kjo do të jetë e njëjtë. Por, u dëshmua se është e vështirë të organizohen gjykimet atje ku ndodhen kryesit e krimeve dhe ekziston frika nga dëshmia. Ne duhet të pranojmë formimin e kësaj gjykate, si një mekanizëm i cili do të sjellë më shumë drejtësi e do të ketë më pak gabime. Nëse do të jetë ashtu, të gjithë do të fitojmë.

Kelmendi: Zonja Kandiq, ju ia keni dorëzuar këtë "Libër përkujtimi" kryeministrit serb, Vuçiq.

Kandiq: Kur u takova për herë të parë me të, para një viti, ia dhashë librin dhe ai më kishte thënë: Këtë po ma jepni... se çfarë kemi bërë në Kosovë. I thashë: Po, duhet ta dini këtë. Kështu që ai e mori librin dhe ajo çfarë mua atëherë m'u duk shenjë pozitive. Ishte se kërkoja nga ai përkrahje për formimin e komisionit rajonal për verifikimin e fakteve për krime lufte. Këtë përkrahje kurrësi s'mund ta merrja nga ish-presidenti Boris Tadiq.

Kelmendi: Edhe pse ai konsiderohej demokrat.

Kandiq: Po, ne të gjithë e përkrahim atë pushtet demokratik. Edhe pse ai më thoshte se ai s'do të kishte guximin që të pranojë e të bashkëpunojë me Kosovën, ngase nuk e njohim atë shtet. Por Vuçiq më ka thënë se viktimat janë mbi të gjitha dhe se dialogu është kornizë me të cilën duhet të pranohen edhe viktimat, derisa Serbia është e gatshme për bashkëpunim me Kosovën. Mes tjerash ne e dimë se kush janë Vuçiq e Nikoliq, por po ashtu e dimë se nga ata prej të cilëve e prisnim të nisin këtë çështjen e raporteve mes serbëve e Kosovës nuk e kanë bërë. Vuçiq është politikani i parë që bëri diçka konkrete. Ai tha po, raporti duhet të ndryshojë dhe Serbia pranon që të marrë pjesë në këtë. Fakti që ai e kishte emëruar delegatin për REKOM dhe jep përkrahje, mua m'u duk e mirë. Nuk mendoj tash që ky pusht i ri është demokratik, por besoj fuqimisht se nuk ka pajtim dhe bashkëpunim rajonal në njohjen e asaj që ndodhi nëse ata të cilët morën pjesë në sjelljen e vendimeve nuk marrin pjesë në këtë proces. Andaj, për mua kishte rëndësi që kryeministri Vuçiq, konsideron se Kosova dhe Serbia duhet të marrin pjesë bashkërisht në këtë projekt rajonal që kjo iniciativë civile duhet të shndërrohet në projekt ndërshtetëror. Por, tani kjo situata me gjeneralin Diković, është një sfidë krejtësisht e re dhe, do të thosha, shumë e vështirë.

Kelmendi: Si po shkon procesi REKOM?

Kandiq: Procesi i REKOM-it është një proces i komplikuar, por asnjëherë më parë nuk kishte ndonjë proces tjetër, të iniciuar nga shoqëria civile e të ketë shkuar kaq larg. Ne morëm përkrahjen nga të gjithë kryetarët, por siç kishte thënë një herë profesori Zharko Puhovski, ne si shoqëri civile jemi në situatë që gjithnjë të përgjërohemi, jemi në situata që të përgjërohemi dhe të lutemi dhe të presim që një president të tregojë vullnetin e mirë dhe të takohet me ne, të dëgjojë çfarë kemi për të thënë dhe kjo zgjat me vjet. Kishim përkrahje të madhe nga ana e presidenti kroat, Josipović, por gjithnjë jemi në situata që kemi burime dhe që procesi i mëtutjeshëm të varet nga burimet. Kjo gjithmonë përsëritet dhe vazhdimisht jemi në situata që diku në një pjesë të ish-Jugosllavisë duhet të fillojmë nga fillimi. Tash prapë kemi konsultime në Kroaci dhe me kryesinë e Bosnjës, ngase është e re kështu që të gjitha pajtimet rreth përkrahjes që kishim duhet të kthehemi prapë edhe në Bosnjë, edhe Kroaci dhe shpresojmë që të mos ketë zgjedhje të reja. Në Kosovë pritet të ketë zgjedhje vitin e ardhshëm. Ky "Libër kujtimi" i Kosovës do të mund t'i shërbente ministrit serb në Kosovë, Aleksandër Jabllanović, i cili kishte thënë se nuk e di për krimet që ishin kryer në Kosovë dhe Gjakovë. E dini se çfarë ndodhi pas kësaj deklarate dhe ai dje u shkarkua nga posti i ministrit, pas protestave të nënave gjakovare dhe njerëzve nga opozita për këtë deklaratë.

Janë këtu dy gjëra. Një është mosinformimi i ministrit për atë që ndodhi në Gjakovë, sepse nuk është një fshat ku u vranë disa njerëz. Në komunën e Gjakovës ndodhën krime masive në vetë qytetin dhe fshatra dhe këto janë krime për të cilat duhet të dihet. S'mundet dikush që është ministër të mos dijë asgjë për këtë. Kështu ai bëri gabim të madh politik që nuk mund të

arsyetohet. Nëse ishte kjo mosgjendshmëri ose ndoshta ia vlente që pas kësaj të kishte thënë: Mirë, unë s'di, por dua t'i mësoj detajet dhe të thotë që për këtë e obligon funksioni i tij. Por, ai s'e tha këtë. Kur bëhet fjalë për atë që këto kërkesa për shkarkimin e tij rrjedhin pikërisht nga Gjakova dhe OSQ "Nënat Gjakovare", është një gjë që mua tashmë shumë vjet më godet fuqishëm. Në Kosovë ndodh shpesh herë që serbët që vijnë të vizitojnë varrezat ekspozohen ndaj incidenteve të rënda. Ata sulmohen me gurë, u ndalohet hyrja në kisha dhe të gjitha këto janë qerim hesapesh mbi të vdekurit. Kjo është e palejueshme. Për mua, unë në Gjakovë isha shpesh dhe aty ka shumë njerëz të mirë, të cilët s'do t'i lejonin vetës që të qeronin hesapet mbi të vdekurit, monument e kisha. Por kjo ndodhi në Gjakovë, dhe duhet të ndalet. Nuk duhet të ketë qerim hesapesh mbi të vdekurit, s'bënë të rrëzohen monumentet. Të vdekurit duhet të respektohen njëjtë. Ata që kanë vdekur, këtu s'ka polemika më e qerim hesapesh, sepse të gjithë të vdekurit janë të barabartë, jo në jetë. S'bënë dikujt t'i ndalohet hyrja në kishë dhe të sulmohen me gurë shkaku i të vdekurve. Atë çfarë e kishte thënë ministri Jabllanoviq dhe përdori termin 'egërsira' është e palejueshme. Kjo s'është as zhargon i rrugës, e ai është politikan. Dhe duhet të mendojë se çfarë termi të përdorë. Ai ka mundur të nxirret nga kjo situatë, duke shkuar në Gjakovë, edhe nëse do ta kishin sulmuar dhe atje të kërkojë falje. Mendoj se gjithçka do të ishte ndryshe. Ky është një mësim, nga i cili duhet të mësojë një politikan, sidomos ai që për herë të parë u zgjodh në një pozicion të lartë si Jabllanoviq, duhet të ketë kujdes se si flet dhe si reagon dhe duhet të dijë se çfarë ndodhi në Kosovë. Në anën tjetër, në Kosovë duhet të ndalet kjo praktikë e sulmeve dhe qerimit të hesapeve, mostolerancës ndaj atyre që vijnë të vizitojnë monumentet.

Kelmendi: Meqë jemi në fund të emisionit, çfarë mendoni, a mund të ketë pajtim mes dy popujve pa kërkuar falje nga ana serbe, edhe pse Serbia nuk e pranon Kosovën si shtet?

Kandiq: Ekzistojnë mendime të ndryshme. Unë mendoj që faktet kanë fuqinë më të madhe dhe nuk është e lehtë të luftosh për faktet. Kjo është luftë e madhe dhe e vështirë, por lufta për fakte dhe të vërtetën duhet të rezultojë me njohje. Nëse formohet ky komision rajonal që të gjitha këto që ne sot i bëjmë, emërimin e viktimave, verifikimin e rrethanave, krijimin e një baze të të dhënave të besueshme do të ndihmojë që të ndërtohet një strukturë e fakteve, që do t'u shërbejë politikanëve t'i njohin viktimat. Pa i njohur viktimat, nuk ka pajtim. Viktimat qëndrojnë mbi çdo shtet. Serbia i ka pranuar institucionet e Kosovës, por e kemi atë qëndrimin politik që vazhdimisht përsëritet, që Serbia në aspekt ligjor nuk e njeh Kosovën, kështu që kjo del të jetë të themi si një 'fluskë politike'. Sepse tregon që shumë pak kujdesemi për njerëzit. Madje politikanët serbë nuk kujdesen as për serbët në Kosovë. Për serbët në Kosovë është me rëndësi që të kenë bashkëpunim të mirë me institucionet e Kosovës, andaj është mirë që dialogu në Bruksel të fillojë me kapitullin 35, për të parë se çfarë nënkupton bashkëpunimi rajonal. Bashkëpunimi rajonal në rastin e Kosovës e Serbisë është ai që flet për të shkuarën dhe të ardhmen, sepse nëse e shkuara nuk mund të pranohet, është e vështirë që sidomos për serbët në Kosovë të jetë më mirë. Këtë duhet pasur parasysh. Nisem nga fakt se ndoshta duhet të mësojmë diçka nga perioda e pushtetit të shkuar. Sepse asnjë hap nuk është bërë që serbët në Kosovë ta kenë më mirë. Po ta bënim një anketë dhe t'i pyesnim serbët nëse për ta është më e rëndësishme që Serbia të mos e njohë Kosovën, ose që bashkëpunimi mes Serbisë dhe Kosovës të jetë i mirë, jam e sigurt që të gjithë do të thoshin se për ta është më e rëndësishme bashkëpunim mes institucioneve. E ky bashkëpunim është një prej mënyrave dhe kornizave në të cilat shtetet në aspektin e duhur e pranojnë njëra-tjetrën.

Kelmendi: Zonja Kandiq, faleminderit për intervistën.

© KOHA.net

Bp Home Investment - bp-home.com

Mundësi blerje me norma shumë të volitshme interesi. Kliko për më shumë

Kolegji Universum - facebook.com/Universum

Transfero Studimet dhe fito 30% bursë. APLIKO ONLINE

Httpool Ads

0 Komete**Koha.net**

Rendit sipas më të mirave ▾

Shpërndaje E preferuar ★



Filloni diskutimin...

Bëhu i pari që komenton.

Regjistrohu

Përdoreni Disqus në faqen tuaj

Privatësia

DISQUS**TË FUNDIT**



Miratohet Rezoluta kundër migrimit (?id=27&l=43636)



Në çerekun e fundit të 2014-shit në Kosovë u regjistruan 2175 ndërmarrje (?id=27&l=43634)



Janë regjistruar mbi 100 mijë ndërtime pa leje (?id=27&l=43632)



Konjufca: Mustafa e futi Serbinë në Qeverinë e Kosovës (?id=27&l=43631)



Lista Serbe vendos pas dialogut në Bruksel (?id=27&l=43630)



Të shtunën protestat e grupit qytetar edhe duke pirë kafe (?id=27&l=43629)

RRJETET SOCIALE



TË TJERA

Kapet në Tiranë turku që vidhte bankat me me karta të klonuara (?id=3&l=43637)

5 Shkurt 2015 - 15:22

Miratohet Rezoluta kundër migrimit (?id=27&l=43636)

5 Shkurt 2015 - 15:16

Ahmeti: Sami Hamiti dhe Lirak Çelaj votuan për familjet e veta në ndërmarrjet publike (?id=8&l=43635)

5 Shkurt 2015 - 15:14

Në çerekun e fundit të 2014-shit në Kosovë u regjistruan 2175 ndërmarrje (?id=27&l=43634)

5 Shkurt 2015 - 15:12

Hiqet ora policore në Bagdad (?id=22&l=43633)

5 Shkurt 2015 - 15:04

KARIKATURA E DITËS



(?id=29&k=336)

Jeton Mikullovc

Galeria > (?id=29&k=336)

KOHA_{net} (<http://koha.net>)

Lajme (?id=2) • Kronikë (?id=3) • Kulturë (?id=4) • Mespërmes (?id=5) • Vështrimë (?id=26)

• Sport (?id=6) • Lëmsh (?id=7)

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Portali Koha.net / Zhvilluar nga Frakton
(<http://www.frakton.com>)

☎ 038 249 105 ✉ info@koha.net (mailto:info@koha.net) 📍 Sheshi Nënë Tereza pn, Prishtinë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale.

Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. **Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.**

